

VENDIM
Nr. 35, datë 24.1.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 584, DATË 28.8.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, pika 4, dhe 25, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 42, të kreut V, shtohet pika 42/1, me këtë përmbajtje:

“42/1. Projektakti, pas marrjes së mendimeve të ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, së bashku me dokumentacionin sipas pikës 45, të kreut VI, të kësaj rregulloreje, i paraqitet për konsultim dhe vlerësim grupimit ministror, ku bën pjesë edhe ministri propozues.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku